



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

VENDIM

K.P.P. 824/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 05.12.2018, shqyrtoi ankesat me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik “Shëndelli” sh.p.k., në procedurën e prokurimit “Kërkesë për propozim”, me nr. REF-84871-09-06-2018, me objekt “Përmirësim i furnizimit me ujë Lagja Baromet Nj. Adm Sukth, Bashkia Durrës”, me fond limit 9.066.748 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 24.09.2018, nga autoriteti kontraktor Sh.a. Ujësjiellës Kanalizime Durrës.

Ankimues:

Operatori ekonomik “Shëndelli” sh.p.k.
Lagja Kastrioti, Rruga “Mico Plaka”, 2 kullat, Fier

Autoriteti Kontraktor:

Sh.a. Ujësjiellës Kanalizime Durrës
Lagja Nr. 17, Rruga “Dalip Peza”, Durrës

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet dhe pretendimet me shkrim të operatorit ekonomik ankimues, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti kontraktor dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, të dokumentacionit të dërguar nga operatori ekonomik ankimues dhe autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se, mbështetur në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, operatori ekonomik ankimues ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe, më pas, ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.3. Ankimesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 07.09.2018 në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit “ *Kërkesë për propozim*”, me nr. REF-84871-09-06-2018, me objekt “*Përmirësim i furnizimit me ujë Lagja Baromet Nj. Adm Sukth, Bashkia Durrës*”, me fond limit 9.066.748 lekë (pa TVSH).

II.2. Në datën 24.09.2018, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.3. Në datën 28.09.2018, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, për procedurën e prokurimit objekt ankimi, ku rezulton si më poshtë vijon:

1. "Shëndelli" sh.p.k.	7.980.265 lekë, skualifikuar
2. "Be - Is" sh.p.k.	8.687.160 lekë, kualifikuar
3. "Al Asfalt" sh.p.k.	8.950.000 lekë, skualifikuar
4. "Kronos Konstruksion" sh.p.k.	8.990.182 lekë, skualifikuar
5. "Liqeni VII" sh.p.k.	9.000.000 lekë, skualifikuar
6. "Alen Co" sh.p.k.	nuk ka paraqitur ofertë ekonomike

II.4. Në datën 28.09.2018, operatori ekonomik “Shëndelli” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me arsyet si më poshtë vijon:

•Operatori ekonomik “SHENDELLI” është skualifikuar për arsye se nuk përmbush:

1.Kapacitetin Teknik pika 5/a pasi;

-Nuk ka paraqitur pajisje semaforë të levizshëm

2.Kapacitetin Teknik pika 6/ pasi;

-Autorizimi i distributorit, katalogu të paraqitur nga operatori nuk është për produktin sipas specifikimeve teknike të këtij objekti, përkatësisht jo për tuba HDPE RC.

II.5. Në datën 02.10.2018 operatori ekonomik ankimes ” Shëndelli” sh.p.k ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke kundërshtuar vendimin e KVO-së lidhur me skualifikimin e ofertës së tij, me argumentimin si më poshtë vijon:
[...]

Firma “Shëndelli” sh.p.k. ka marrë pjesë në procedurën e prokurimit elektronik për objektin “Përmirësim i furnizimit me ujë Lagja Baromet Nj. Adm Sukth, Bashkia Durrës”, me fond limit 9.066.748 lekë pa tvsh që zhvillohet nga autoriteti kontraktor Ujësljellës Kanalizime Durrës.

Në datën 03 Shtator 2018 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Eletronike, procedura e prokurimit “Kërkesë për Propozim” me objekt “Përmirësim i furnizimit me ujë Lagja Baromet, Nj. Adm. Sukth, Bashkia Durrës”, me fond limit 9.066.748 lekë pa tvsh.

Më datë 24 shtator 2018 Autoriteti kontraktor zhvillonte procedurën me objekt ankimimi.

Më datë 28 shtator 2018 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (SPE) operatorët për renditjen.

Operatorët ekonomikë	vlerat të ofertuara	refuzuar	arsye
Alen - Co	0.00	po	
Shendelli	7980265.00	po	
Be – IS shpk	8687160.00	jo	
A.L – Asflat	8950000.00	po	
Kronos Konstruksion	8990182.00	po	
Liqeni VII	9000000.00	po	

Arsyet e skualifikimit

Operatori ekonomik “Shendelli” sh.p.k. është skualifikuar për arsye se nuk përmbush: 1. Kapacitetin teknik pika 5/a pasi: - Nuk ka paraqitur pajisje semaforë të lëvizshëm 2. Kapacitetin Teknik pika 6/ pasi: - Autorizimi i distributorit, katalogu të paraqitur nga operatori ekonomik nuk është për produktin sipas specifikimeve teknike të këtij objekti, përkatësisht jo për tuba HDPE RC.

Më datë 02 Tetor 2018 operatori ekonomik “Shëndelli” shpk kundërshton arsyen e skualifikimit jo të drejtë pa bazuar në fakte dhe ligje.

Skualifikimi arsyeja:

- operatori ekonomik “Shëndelli” sh.p.k. është skualifikuar për arsye se nuk përmbush: 1. Kapacitetin teknik pika 5/a pasi: - Nuk ka paraqitur pajisje semaforë të lëvizshëm

Kundërshtimi:

A. Autoriteti kontraktor midis të tjerave kërkon Kapaciteti Teknike pika 5:

Operatori ekonomik “Shëndelli” shpk ka paraqitur dokumentin me emërtimin.... Shëndelli

Fatura të ndryshme 2.... Ku gjithsej ka 53 fletë dhe ... Shëndelli Fatura të ndryshme 3.... Ku gjithsej ka 53 fletë. Në Faturën nr. Serial 36575810 datë 20.11.2017 ju kemi paraqitur element sinjalistike, faturë nr. Serial 41228523 datë 10.11.2017 ju kemi paraqitur element sinjalistike, faturë nr. 26857633 datë 12.02.2016 ju kemi paraqitur feneline me bateri, faturë nr serial 26957770 datë 01.03.2017 ju kemi paraqitur tabela sinjalistike, faturë nr. Serial 19643176 datë 23.06.2017 ju kemi paraqitur tabela sinjalistike. Ne ju kemi paraqitur më shume se ju kërkon.

Rrjedhimisht skualifikimi për këtë arsye nuk qëndron.

Skualifikimi arsyeja
2. Kapacitetin teknik pika 6/ pasi: - Autorizimi distributorit katalogu të paraqitur nga operatori nuk është për produktin sipas specifikimeve teknike të këtij objekti, përkatësisht jo për tuba HDPE RC.

Kundërshtimi

Autoriteti kontraktor midis të tjerave kërkon te Kapaciteti Teknik pika 6

Operatori ekonomik "Shëndelli" sh.p.k. ka paraqitur dokumentin me emërtimin "Shëndelli kontratë furnizimi tubo England ---- ku gjithsej ka 35 fletë.

Kontrata e furnizimit noteriale që prodhuesi i kompanisë England (ku ju kemi paraqitur dhe dokumentat që kompania ka linjë prodhimi materiale tubo ujësjellësi të dimensioneve të ndryshme. 1. –kontratë shitblerje, 2 – zhdoganimin e makinerisë, 3 – çertifikatë cilësie) do të furnizojë Firmën Shëndelli sipas kërkesës që kjo firmë do të bëjë për nevojat që ka. Në këtë file ju kemi paraqitur dhe katalogun e prodhimit të tubove plastike të të gjitha dimensioneve shoqëruar me specifikimet teknike për secilin tub edhe për tub HDPE RC. Duke u bazuar në preventivin e punimeve kompania prodhuese England i prodhon këta tuba, sipas katalogut dhe specifikimeve të paraqitura në këtë prokurim.

Është diskriminues skualifikimi për këtë arsye. Bazuar në ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 konkretisht neni 1, neni 2, neni 20, neni 46.

Rrjedhimisht skualifikimi për këtë arsye nuk qëndron.

Neni 1 [...]

Neni 2 [..]

Neni 20 [...]

Sa më sipër, skualifikimi i kryer prej KVO-së së AK – Ujësjellës Kanalizime SH.a. Durrës, për këtë arsye nuk qëndron, pasi nuk përputhet me ato çfarë ju pretendoni në këtë skualifikim dhe ato çfarë ne ju kemi paraqitur në tender.

Për autoritetin kontraktor UK sh.a. Durrës është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetin dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale dhe në rastin konkret "Shëndelli" sh.p.k. i plotëson këto kualifikime.

Sa më sipër, me anën e kësaj ankese, kërkojmë rivlerësim dhe kualifikimin e operatorit ekonomik "Shëndelli" shpk dhe shpalljen fitues për prokurimin duke parë dhe ofertën që është më ekonomike.

II.6. Në datën 04.10.2018, me shkresën nr. 2049/1 prot., i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues duke e pranuar pjesërisht ankesën.

Konkretisht autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes drejtuar operatorit ekonomik ankimues argumenton si më poshtë vijon:

[...]

Në lidhje me pikën e parë AK në dokumentat e tenderit, Shtojca 11 "Kriteret e veçanta të kualifikimit", pika 2.3. "Kapaciteti teknik", ka përcaktuar si kriter:

“Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim Prodhuesi/distributori katalogjet ose fragmente të katalogjeve për tubat dhe rakorderitë, i shoqëruar me certifikatë ISO 9001:2015 të prodhuesit të mallit”.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik “Shëndelli” sh.p.k., rezulton se në përmbushje të kriterit të mësipërm nga ana juaj është paraqitur: “Kontratë furnizimi me kompaninë England dhe katalog për tuba HDPE. Operatori ekonomik Shëndelli shpk nuk ka paraqitur katalog për tuba HDPE RC sic janë kërkuar në DST.

Në nenin 46 parashikohet [...]

Sa më sipër grupi i shqyrtimit të ankesave konstaton se katalogu i paraqitur nga operatori ekonomik “Shëndelli” sh.p.k. nuk janë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor dhe nuk janë të vlefshme, pasi AK ka kërkuar që katalogjet ose fragmentet e katalogjeve të jenë për tubat HDPE RC. Referuar seksionit II të dokumentave të tenderit “Udhëzime për operatorët ekonomikë” përcaktohet qartë se: “Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DST. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DST do të refuzohen si të papranueshme”. Nga sa më sipër, ankesa e bërë në lidhje me këtë pikë nuk meret në konsideratë.

Gjithashtu ju bëjmë me dije se AK ka kërkuar vendosjen e tubave HDPE RC pasi vendosja e këtij tubi nuk kërkon shtresë rëre. Ndërsa vendosja e tubacioneve HDPE e ka të domosdoshme vendosjen e shtresës së rërës.

2. Në lidhje me pikën e dytë AK në dokumentat e tenderit Shtojca II “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3 “Kapaciteti teknik”, është përcaktuar kriteri: “Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesë dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion të cilat janë si më poshtë.... Semaforë të lëvizshëm 4 copë.

Në lidhje me pikën e dytë pretendimi i ngritur nga ana juaj qëndron pasi AK ka kërkuar dëshmi për pajisjet teknike “... semaforë të lëvizshëm” dhe OE në lidhje me këtë pikë ka paraqitur si dëshmi faturat e blerjes së tabelave sinjalistike.

Nga sa më sipër, ju vëmë në dijeni se ankesa e paraqitur nga ana e juaj më datë 02.10.2018 është marrë pjesërisht në konsideratë.

II.7. Në datën 12.10.2018 operatori ekonomik ankimues “Shëndelli” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik duke kundërshtuar arsyen e skualifikimit të lënë në fuqi nga autoriteti kontraktor, në të cilën argumenton të njëjtat pretendime si edhe në ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.8. Në datën 25.10.2018 nëpërmjet shkresës me nr. 2173/2 prot., datë 24.10.2018, me objekt “Kthim përgjigje”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentacioni dhe informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Shëndelli” sh.p.k.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "Shëndëlli" sh.p.k. se arsyeja e skualifikimit "Operatori ekonomik "SHENDELLI" është skualifikuar për arsye se nuk përmbush:

2.Kapacitetin Teknik pika 6/ pasi;

-Autorizimi i distributorit, katalogu të paraqitur nga operatori nuk është për produktin sipas specifikimeve teknike të këtij objekti, përkatësisht jo për tuba HDPE RC", nuk qëndron, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 11, pika 2.3. Kapaciteti teknik, pika 6, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri si më poshtë vijon:

"Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim Prodhuesi/distributori katalogjet ose fragmente të katalogjeve për tubat dhe rakorderite, i shoqëruar me certifikatë ISO 9001:2015 të prodhuesit të mallit ose certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, certifikatën e mësipërme duhet ta paraqesë anëtarë i grupit që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit do të marrë përsipër realizimin e zërit FV të referuar preventivit të objektit të prokurimit)"

Gjithashtu në dokumentat e tenderit të publikuara për këtë procedurë prokurimi, në sistemin e prokurimeve elektronike nga ana e autoritetit kontraktor është publikuar edhe preventivi me zërat përkatës të punëve që do të bëhen si më poshtë vijon:

PREVENTIV

OBJEKTI: PËRMIRËSIMI I FURNIZIMIT ME UJË LAGJA BAROMET NJ.ADM SUKTH ,BASHKIA DURREËS

Nr.	Pershkrimi i punimeve	Njesia	Sasia	Çmimi	Vlera
1	Linja shperndarese				
1	Germim kanali me makineri	m ³	868		-
2	Germim kanali me krahe	m ³	217		-
3	Transport dheu deri 5 km	m ³	1085		-
4	Prerje asfalti	m ²	933.8		-
5	Shtrese Asfaltobetoni 4 cm	m ²	933.8		-
6	Shtrese binderi t = 6 cm	m ²	933.8		-
7	Shtrese stabilizanti t = 20 cm	m ²	933.8		-

8	Shtrese çakulli mbeturine, t=10cm	m ²	933.8		-
9	Sperkatje me bitum 0.5 kg/m ²	m ²	933.8		-
10	Mbushje me material te germuar me pare	m ³	77		-
11	Mbushje ngjeshje me zhavorr	m ³	422		-
12	F.V Tub PE 100 RC Ø90 mm PN 10 atm	ml	232.5		-
13	F.V Tub PE 100 RC Ø75 mm PN 10atm	ml	398.3		-
14	F.V Tub PE 100 RC Ø63 mm PN 10 atm	ml	337.4		-
15	F.V Tub PE 100 RC Ø50 mm PN 10 atm	ml	632		-
		Shuma 1		-	
2 Rakorderi ujesjellesi per lidhjen me rrjetin ekzistues, NYJA 1					
1	F.v Fllanxhe-adaptor Dn 80 - Dj 90 mm	cope	2		0
2	F.v Saraçineskë Ø80 mm Pn 16	cope	1		0
3	F.V Manikote EF PE100 Dj 90 mm	cope	2		0
		Shuma 2		-	
4	Pusete shperndarese Tip 2 (me 8 dalje)				
1	Germim kanali me krahe	m ³	0.24		-
2	Transport dheu deri 5 km	m ³	0.24		-
3	Beton M-200 per bazamentin	m ³	0.175		-
4	F.V.Kasete metalike 100x80x25 cm	cope	1		-
5	F.V Tuba e rakorderi PPR Pn 16 f = 50 mm	ml	1		-
6	F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~25mm, PN 16	ml	16		-
7	F.V Valvul ajernxjerresi 1"	cope	1		-

8	F.v kryqe PPR Pn 16 f =50x 1/2"	cope	4	-
9	F.v Adaptor me ngjitje PPR f=50x1" f	cope	1	-
10	F.v Adaptor me ngjitje PPR f=50x1 1/2" mm	cope	1	-
11	F.V saracineska bronzi Ø 50 mm	cope	1	-
12	F.v Adaptor PE f=50x1 1/2" mm	cope	1	-
13	F.v Berryl 90 PE f=50 mm	cope	1	-
14	F.v brryle bronxi 1/2 " f me kompresion	cope	8	-
15	F.V saracineska bronzi Ø 1/2 " = 15 mm M-F	cope	8	-
16	F.V kondravalvul bronzi Ø 1/2 " = 15 mm M-F	cope	8	-

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik ankimues në sistemin e prokurimeve elektronike, në përmbushje të kriteve të mësipërme, rezulton se ka dorëzuar:

- Kontratë furnizimi të lidhur në datën 05.07.2017 ndërmjet shoqërisë “Egland” sh.p.k. në cilësinë e furnizuesit dhe shoqërisë “Shëndelli” sh.p.k. në cilësinë e porositesit, ku përcaktohet se shoqëria “Egland” sh.p.k. do të furnizojë me materiale tuba plastike të të gjitha kategorive që ajo prodhon dhe tregton, sipas kërkesave dhe nevojave që do të ketë shoqëria “Shëndelli” sh.p.k.;
- Katalog prodhimi për tuba HDPE
- Çertifikatë Iso 9001:2015 të shoqërisë “Egland” sh.p.k.
- Kontratë shitblerje ndërmjet shoqërisë “Zerja” sh.p.k. si shitës dhe shoqërisë “Egland” sh.p.k. si blerës për makineri për prodhim tuba plastike; shoqëruar me fletë zhdoganimi dhe ekstrakt të regjistrimit tregëtar të shoqërisë “Egland” sh.p.k.
- Çertifikatë cilësie të shoqërisë “Egland” sh.p.k.

III.1.3. Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.

III.1.4. Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.

III.1.5. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës.

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme, në mbështetje edhe të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.

III.1.6. Operatori ekonomik në ankesën e paraqitur pretendon se: *Operatori ekonomik “Shëndelli” sh.p.k. ka paraqitur dokumentin me emërtimin “Shëndelli kontratë furnizimi tubo England ---- ku gjithsej ka 35 fletë.*

Kontrata e furnizimit noteriale që prodhuesi i kompanisë England (ku ju kemi paraqitur dhe dokumentat që kompania ka linjë prodhimi materiale tubo ujësjellësi të dimensioneve të ndryshme. 1. –kontratë shitblerje, 2 – zhdoganimin e makinerisë, 3 – certifikatë cilësie) do të furnizojë Firmën Shëndelli sipas kërkesës që kjo firmë do të bëjë për nevojat që ka. Në këtë file ju kemi paraqitur dhe katalogun e prodhimit të tubove plastike të të gjitha dimensioneve shoqëruar me specifikimet teknike për secilin tub edhe për tub HDPE RC. Duke u bazuar në preventivin e punimeve kompania prodhuese England i prodhon këta tuba, sipas katalogut dhe specifikimeve të paraqitura në këtë prokurim”.

III.1.7. Autoriteti kontraktor sqaron se: *Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik “Shëndelli” sh.p.k., rezulton se në përmbushje të kriterit të mësipërm nga ana juaj është paraqitur: “Kontratë furnizimi me kompaninë England dhe katalog për tuba HDPE. Operatori ekonomik Shëndelli shpk nuk ka paraqitur katalog për tuba HDPE RC sic janë kërkuar në DST. [...] Gjithashtu ju bëjmë me dije se AK ka kërkuar vendosjen e tubave HDPE RC pasi vendosja e këtij tubi nuk kërkon shtresë rëre. Ndërsa vendosja e tubacioneve HDPE e ka të domosdoshme vendosjen e shtresës së rërës”.*

III.1.8. Komisioni i Prokurimit Publik, nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, konstaton se, nuk është paraqitur asnjë katalog në lidhje me tubat HDPE RC, të kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, tuba këto të cilat kanë një ndryshim të konsiderueshëm në lidhje me tubat HDPE përse i përket metodologjisë së vendosjes së tyre. Konstatohet, ashtu siç edhe autoriteti kontraktor argumenton, se, janë paraqitur katalogë vetëm për tubat HDPE, në kundërshtim me kriterin e përcaktuar në dokumentat e tenderit nga ana e autoritetit kontraktor, i cili përcakton se duhet të paraqiten katalogë ose fragmente të katalogjeve për tubat dhe rakorderitë, sipas zërave të përcaktuara në dokumentat e tenderit, kriter ky që nuk është përmbushur nga ana e operatorit ekonomik ankimues me dokumentacionin e paraqitur prej tij në sistemin e prokurimeve elektronike.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, me anë të dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike, operatori ekonomik ankimues nuk plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, e si rrjedhim dokumentacioni i tij nuk konsiderohet i vlefshëm.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Shëndelli” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Kërkesë për propozim”, me nr. REF-84871-09-06-2018, me objekt “Përmirësim i furnizimit me ujë Lagja Baromet Nj. Adm Sukth, Bashkia Durrës”, me fond limit 9.066.748 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 24.09.2018, nga autoriteti kontraktor Sh.a. Ujësjetellës Kanalizime Durrës.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1596 Protokolli

Datë 12.10.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha